



**VAKËFI I FUSHË ÇELËS,
DËSHMI E BEKIMIT TË GRABITJES
SË PRONËS LEGJITIME!**



**NDOSHTA TË DUKEN TË
VOGLA, POR...**



**TOTEMIZMI
HISTORIA E NJERIUT
QË KËRKONTE HYJNOREN**

UDHA ISLAME

Viti 23 - Nr. 10 (272), Tetor, 2025

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

“ÇDO PROJEKT MBI PRONË TË GRABITUR KA MALLKIMET E ZOTIT!”



Xhamia e Fushë Çelës - 1931

REAGIM MBI PRONËN VAKËF NË SHKODËR
DHE NDËRTIMIN E PALIGJSHËM MBI TË

SOT, 30 VJET XHAMIA E MADHE
NË FUSHË ÇELË

PËRURONET QENDRA KULTURORE
BARDHAJ

MYFTINIA SHKODËR DHE KISHA
ORTODOKSE KRAH PËR KRAH
NË MBROJTJE TË SË DREJTËS SË PRONËS

BAMIRËSI SAUDIT, ZAMIL IBN ABDULLAH
EZ-ZAMIL URON MYFTIUN E SHKODRËS
ME RASTIN E 30-VJETORIT TË XHAMISË “EBU BEKËR”

REPUBLIKA ARABE E SIRISË
NJEH ZYRTARISHT KOSOVËN
SI SHTET TË PAVARUR

VAKËFI I FUSHË ÇELËS, DËSHMI E BEKIMIT TË GRABITJES SË PRONËS LEGJITIME!

Kaluan 35 vite dhe në vend që sot të ishim rehat në xhamitë tona, të certifikuara, të kopsitura siç duhet, vazhdojmë të ngrejmë zërin, të shqetësohemi e të trazohemi, por të trazojmë edhe të tjerët, për një feshad shumë e shumë të madh, me të cilin ne përballemi ditë-natë, dhe që çuditërisht dhe paradoksalisht nuk ka zgjidhje, e që në fakt zgjidhjen e ka shumë të lehtë, mirëpo pse nuk e gjen zgjidhjen, që e ka shumë të lehtë?!

Në vazhden e informimit të masës së gjerë për zullumin e madh që po bëhet tek vakëfi i Fushë Çelës, i cili është grabitur në mënyrë flagrante dhe haku i Myftinisë Shkodër, që kërkohet prej më shumë se 30 vitesh, jo vetëm që nuk është kthyer, por dikush tjetër po e administron!

Këto ditë kanë nisur punimet për ngritjen e një objekti të çuditshëm në zemër të Shkodrës, në një pronë të njohur nga mbarë Shkodra si vakëfi i Fushës së Çelë Zylyftarit, por që paradoksalisht, i është certifikuar padrejtësisht jo të zotit legjitim; Myftinisë Shkodër/Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Për këtë çështje, Myftinia Shkodër e ka ngritur zërin në vazhdimësi, sikurse ka punuar sistematikisht me gjyqe e shkresa pa fund, për arritjen e të drejtës legjitime!

Bëjmë me dije se vakëfi i Fushë Çelës është pjesë legjitime e hartës së gjerë të vakëfeve të Shkodrës, për të cilën datojnë harta dhe dokumente të shumta, të cilat janë paraqitur në gjykata e institucione, ku besohet të fitohet e drejta, por që në këtë rast, e drejta e vakëfit është tjetërsuar dhe zhvatur barbarisht e në mënyrë primitive!

Fatkeqësia e madhe që kaploi kombin shqiptar me periudhën e errët të sistemit komunist bëri që shkatërrimi i xhamive

dhe tjetërsimi i pronave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të sjellë realitete të padëshiruara, me të cilat vazhdojmë të përballemi akoma edhe sot, edhe pse kanë kaluar 35 vite nga dita kur perdja e errët e komunizmit u duk se kishte rënë në këtë vend!?

Ditën e xhuma, më 3 tetor 2025, nëpërmjet ligjëratës së përjavshme në xhaminë e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari vazhdoi të tërhiqte vëmendjen për abuzimin flagrant që është bërë me vakëfet e Myftinisë Shkodër në përgjithësi.

Myftiu theksoi se: “Të xhumanë e kaluar u ndalëm te fesadi i madh, me të cilin përballemi te xhamia e madhe (Fushë Çelë). Në fakt nuk është vetëm xhamia “Ebu Bekër”, por shumë e shumë vakëfe të Myftinisë tonë, e shumë e shumë prej xhamive të Shkodrës përballen në këto 35 vite me një feshad të papranueshëm!

Është e çuditshme, sepse ne mendonim dhe besonim, të hutuar, se me rënien e perdes së komunizmit ky vend do të shpëtonte!

Kaluan 35 vite dhe fesadi i pronave ngeli si një gozhdë e ndryshkur në trupin e këtij vendi, që e duam dhe e kemi të shtrenjtë!

Kaluan 35 vite dhe në vend që sot të ishim rehat në xhamitë tona, të

certifikuara, të kopsitura siç duhet, vazhdojmë të ngrejmë zërin, të shqetësohemi e të trazohemi, por të trazojmë edhe të tjerët, për një feshad shumë e shumë të madh, me të cilin ne përballemi ditë-natë, dhe që çuditërisht dhe paradoksalisht nuk ka zgjidhje, e që në fakt zgjidhjen e ka shumë të lehtë, mirëpo pse nuk e gjen zgjidhjen, që e ka shumë të lehtë?!

Po flasim për një vjedhje dhe një grabitje flagrante të vakëfit në Fushë Çelë; *unë e kam me tokën tonë që padrejtësisht nuk na është kthyer, e kam me një tokë që është haku i muslimanëve dhe hakun e muslimanëve nuk bën dhe nuk lejohet, as me fe e as me moral kombëtar, as me njerëzillëk dhe as me gjë tjetër, që ta gëzojë i pamunduari; kjo nuk shkon, nuk pranohet dhe nuk tolerohet!*” – u shpreh Myftiu Sytari gjatë kësaj ligjërate.

Myftinia Shkodër vazhdon përballjen e saj legjitime me fenomenin e grabitjes së tjetërsimit të vakëfeve, deri në zgjidhjen e plotë të këtij problemi famëkeq.

Myftinia Shkodër do të vazhdojë të ndjekë të gjitha rrugët legjitime për mbrojtjen e hakut të saj dhe mos tolerimin e këtij krimi barbar me pronën e shenjtë!

MYFTIU I SHKODRËS: “ÇDO PROJEKT MBI PRONË TË GRABITUR KA MALLKIMET E ZOTIT!”



Në ligjëratën e ditës së xhuma, më 10 tetor 2025, që Imam Muhamed B. Sytari, mbajti në xhaminë e Parrucës, në vazhden e komentimit të ajetit 21 të sures ‘Er-Rum’, u ndal përsëri te fesadi i madh, që ka mbuluar vendin tonë në raport me grabitjen pronës së tjetrit, veçanërisht pronës vakëf të muslimanëve.

Myftiu Sytari, ndër të tjera tha: “Gjatë javëve të kaluara kemi ndjekur me shqetësim situatën që është kthyer tashmë në një praktikë të përsëritur ndër vite në vendin tonë: shkeljen e të drejtave të komuniteteve fetare — në rastin tonë, të komunitetit tonë — lidhur me çështjen e pronave.

Kur një komunitet përballlet me një fushatë sistematike, kjo do të thotë se ai po lufton me një sëmundje të thellë, një sëmundje që ende nuk është shëruar, e ndoshta është bërë e pashërueshme. Si pasojë, ne po shohim përhapjen e gangrenës së këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare: përhapjen e zullumit, nxitjen e urrejtjes, përhapjen e të keqes dhe pranimin e masave ekstreme si të drejta..!?

Dhe ju e dini mirë, se ne gjithmonë nxisim që njeriu i mirë dhe besimtari i devotshëm të mos dorëzohet kurrë përballë stuhive të mohimit dhe shejtanit të mallkuar.

Asnjëherë besimtari nuk duhet ta mendojë ikjen, apo braktisjen e vendit të tij, vetëm pse po përballlet me padrejtësi apo sprova. Sepse nëse ti ikën nga rruga e Zotit, ata që përhapin prishjen, gjynahet dhe shthurjen, do ta arrijnë qëllimin e tyre!

Ata duan që vendi ynë, toka jonë, të kthehet në një pjesë të sundimit të së keqes absolute.

Por besimtari i singurtë nuk

dorëzohet. Ai qëndron me durim, me iman dhe me shpresë tek Allahu, derisa drita e së vërtetës të mbizotërojë.

Në këtë kontekst, siç e kam përmendur edhe javën e kaluar, dhe më herët, po e përsëris sërish: po përballemi me një fushatë të madhe grabitjeje dhe shkeljeje të së drejtës sonë legjitime mbi Xhaminë e Madhe.

Së fundmi, kemi parë me tronditje sesi në atë hapësirë është prezantuar një tjetër projekt, i cili – në mënyrë të çuditshme dhe të paturpshme – është paraqitur pa praninë e xhamisë së madhe, madje duke u shfaqur sikur xhamia të mos ekzistonte më në horizont.

Kjo tregon qartë sa i madh është fesadi, sa e thellë është ligësia, dhe sa të guximshëm janë bërë ata që e përhapin këtë padrejtësi në vendin tonë.

Shteti duhet të ndërhyjë urgjentisht! Sepse kjo situatë po e çon shoqërinë drejt përplasjes dhe konfliktit.

Këto veprime po prishin ekuilibrat fetarë, ekuilibrat kombëtarë dhe po hapin rrugën drejt një anarshie sociale që askush nuk do ta dëshironte.

Është e papranueshme që në qytetin e Shkodrës të prezantohet një projekt ku në hartë fshihet Xhamia e Madhe, simboli historik dhe shpirtëror i muslimanëve të këtij qyteti, aq më shumë që vetë ky projekt ngrihet 100% mbi pronën e grabitur vakëf.

Prandaj, është detyrë e shtetit dhe e çdo institucioni përgjegjës të ndalë menjëherë këtë padrejtësi..!

Pa u zgjidhur problemi i pronave në këtë vend, nuk ka standarde qytetëruese!

Nuk ka standarde qytetëruese kur shkelet e drejta flagrante e të zotit të pronës! Nuk ka standarde qytetëruese që të thuash se ka drejtësi, kur njerëzit vriten për një pëllëmbë tokë. Sepse ai që duhet të vendosë të drejtat në vend, ose bëhet palë me shejtanin, ose është bërë vetë iblis, ose nuk e ka mendjen fare se çfarë po ndodh...!”

Gjatë dërsit të tij, Myftiu u ndal edhe te problematik e shumta të vakëfeve të ndryshme të Myftinisë Shkodër, sidomos brenda zonë së qytetit, ku përmendi zaptimet e vakëfit në Kiras, në Rus, tek Bypassi, tek zona e Tabakut, në Perash, grabitjen e vakëfit të xhamisë së Garucit, etj.



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

“**R**ini, ti je shpresa e jonë mbas Zotit (xh.sh) në vendin tonë, ashtu siç ishte rinia në kohën e Profetit (a.s) dhe në ditët e para të fesë.

Rini, bëhu shpirti, toka, dora, goja e munda i Islamit këtu, që të mësohet mirë feja Islame këtu, për t'u zbatuar, për të jetuar me të, për t'u përhapur si drita e diellit që ndriçon botën me jetë më të mirë dhe shtyn insektet e këqija e dëmtuese, të fshihen ose të fiken përherë.

Thotë Zoti (xh.sh.): “Zoti ka dërguar dërkuesin e Tij me udhëzim të plotë, dhe me fenë e vërtetë që do të triumfojë mbi çdo fé, e mjafton Allahu Dëshmues!”

(Nga libri: Syneti e bidati)



REAGIM MBI PRONËN VAKËF NË SHKODËR DHE NDËRTIMIN E PALIGJSHËM MBI TË

Prej më shumë se tre dekadash, kjo pronë ka qenë objekt i një kalvari të gjatë gjyqësor dhe administrativ. Në vitin 1996, me vendimin nr. 1586 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër, prona është njohur në favor të KMSH, me të drejtë parablerjeje të objektit të ndërtuar mbi pronën vakëf.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpreh indignatën dhe shqetësimin e thellë për faktin se, pavarësisht vendimeve të formës së prerë të gjykatave shqiptare, mbi një pronë vakëf në qytetin e Shkodrës ka nisur ndërtimi i kullës “Rozafa Tower”.

Ky veprim përbën një shkelje të hapur të ligjit, një cenim të të drejtës së pronësisë dhe një akt mosrespektimi ndaj institucioneve fetare dhe trashëgimisë vakëf.

Prej më shumë se tre dekadash, kjo pronë ka qenë objekt i një kalvari të gjatë gjyqësor dhe administrativ. Në vitin 1996, me vendimin nr. 1586 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër, prona është njohur në favor të KMSH, me të drejtë parablerjeje të objektit të ndërtuar mbi pronën vakëf. Në vijim, Gjykata Kushtetuese në vitin 1999 dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00.2014.3003(316), datë 24.04.2014, konfirmuan përfundimisht të drejtën e pronësisë mbi këtë truall në favor

të pronarëve legjitimë: Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Kishës Orthodhokse dhe familjes Laçej.

Megjithatë, pavarësisht këtyre vendimeve, institucionet shtetërore, përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Kulturës, Ekonomisë dhe Inovacionit, Zyrën e Përmbarimit Shkodër dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Dega Shkodër, nuk kanë zbatuar detyrimet e tyre ligjore, duke lejuar ndërhyrje të paligjshme mbi pronën dhe duke i hapur rrugën ndërtimit në kundërshtim me çdo akt gjyqësor.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë thekson se moszbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën shkelje të rëndë ligjore dhe vepër penale, që minon parimet themelore të shtetit të së drejtës dhe dëmton besimin e qytetarëve tek institucionet.

Në këtë situatë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të institucioneve shtetërore për zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore që njohin pronësinë e ligjshme, ndërprerjen e çdo veprimi ndërtimor mbi pronën vakëf dhe hetimin e përgjegjësive të zyrtarëve që kanë shpërdoruar detyrën.

Sigurojmë të gjithë besimtarët se Komuniteti Mysliman mbetet i vendosur të vijojë me të gjitha mjetet ligjore mbrojtjen e pronës vakëf.

Nëse kjo e drejtë vijon të cenohet, KMSH do ta ndjekë çështjen deri në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, për të kërkuar zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe dëmshpërblimin për shkeljet e përsëritura.

(www.kmsh.al)



ABDULAZIZ E-TARIFI
(DIJETAR - ARABIA SAUDITE)

“**TË QËNURIT TËND NË TË DREJTËN, NUK DO TË THOTË SE TI NUK DO TË SPROVOHESH E AS NUK DO TË LËNDOHESH; PREJ PEJGAMBERËVE JANË VRARË JAHJAI DHE ZEKERIA; U DËBUA MUSAI DHE U BURQOS JUSUFI;**

U izolua, u qodit dhe u dëbua Zotëria i Pejgamberëve, Muhammedi (a.s), PASTAJ TRIUMFOI E VËRTETA!



SOT, 30 VJET XHAMIA E MADHE NË FUSHË ÇELË



Më 25 tetor 1995 përfundoi së ndërtuari xhamia e Fushë Çelës, e cila mori emrin “Ebu Bekër” sipas dëshirës së donatorit, familjes së nderuar saudite El-Zamil dhe mirëkuptimit të Myftinisë Shkodër.

Lajmi i madh i hapjes së xhamisë “Ebu Bekër” në mes të Shkodrës në vitin 1995 ishte padyshim ngjarja më e rëndësishme e asaj kohe, edhe për faktin se në qendër të veriut të Shqipërisë u ngrit xhamia më e madhe e kohës, e cila do t'i shërbente besimtarëve muslimanë si një vatër më shumë e edukimit me vlerat dhe dritën e udhëzimit islam.

Vlen të theksohet se xhamia “Ebu Bekër” u ndërtua mbi vakëfin e besimtarit dhe bamirësit të shquar shkodran, Çel Zylyftari, lënë vakëf që në vitin 1905.

Më herët në këtë vakëf, ndër vite janë

ndërtuar dhe rikonstruktuar edhe disa xhami të tjera, por në përmasa më të vogla se xhamia aktuale, që mban emrin e sahabiut më të shquar dhe besnikut të Hz. Muhamedit (a.s), Hz. Ebu Bekrit (r.a).

Në këto 30 vite në xhaminë “Ebu Bekër” kanë shërbyer imamllarë, vaizë, muezinë, hatibë dhe myderrizë të ndryshëm, të cilët brenda mundësive të tyre dhe sipas nijeteve të zemrës janë përpjekur për të dhënë më të mirën në shërbim të besimtarëve dhe qytetarëve shkodranë.


Në këtë 30 vjetor të përkujtimit të përrurimit të xhamisë së madhe të Shkodrës, Myftinia Shkodër ngre alarmin e madh të grabitjes flagrante të vakëfeve, një traumë dhe një gangrenë vrastare, e cila vazhdon të shënojë gjurmët e saj shkatërrimtare

në shoqërinë shqiptare, ndonëse kanë kaluar 35 vite nga rënia e perdes së hekurt të komunizmit.

Grabitja flagrante e vakëfit të Fushë Çelës, që tejkalon pragun e rrethimit aktual të kësaj xhamie, është një betejë e pambyllur për Myftininë e Shkodrës dhe Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Përpjekjet për të çuar në vend amanetin e të parëve dhe për të mbrojtur të pacënuar vakëfin e shenjtë të muslimanëve vazhdojnë në të gjitha format dhe mënyrat legjitime në bashkëpunim edhe me miq dhe vëllezër anembanë botës.

Myftinia Shkodër uron besimtarët muslimanë të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë me rastin e përkujtimit të kësaj dite të madhe dhe të shënuar për bashkësinë islame shqiptare.





Naim Drijaj

Imam - Xhamia Parrucë

Jeta është një kapital i çmuar, një begati e madhe që duhet shfrytëzuar siç duhet. Nëpërmjet kësaj begatie, njeriu fiton të gjitha të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Në aspektin kohor, jeta ndahet në tri pjesë: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Njeriu jeton mes këtyre tri fazave. Shumë njerëz e mbajnë veten peng të së kaluarës, duke mos vepruar në të tashmen. Ata thonë: “Është dashur më herët për të vepruar e jo tani!”

E kaluara nuk duhet të jetë pengesë, ajo duhet të trajtohet me keqardhje e pendim dhe duhet të nxjerrim mësim nga gabimet që kemi bërë.

Po e ardhmja si duhet trajtuar? E ardhmja duhet të trajtohet me nijet të mirë e me planifikim.

Në bazë të kësaj ndarjeje, në aspektin praktik, as e kaluara dhe as e ardhmja nuk janë ato që mundësojnë veprimin. Ajo që ia mundëson njeriut veprimin është e tashmja, e sotmja. Sot ke mundësi të ndryshosh, të veprosh, të përmirësosh.

Nëse dikush e ka një gjynah dhe i thuhet: “Lerë sot!”, ai përgjigjet: Sot e

MOS E HUMB TË TASHMEN DUKE PRITUR TË ARDHMEN!

kam të lehtë për ta lënë por nesër si t’ia bëj? Kështu, e ardhmja bëhet pengesë për të sotmen kurse realiteti është që ne nuk e dimë çfarë do sjellë dita e nesërme? Sot largohu nga e keqja dhe lerë të ardhmen se ajo është në dorën e Allahut (xh.sh).

Ne shumë herë e vështirësojmë jetën duke i përzier kohët. Kohën e veprimit me kohën e planifikimit, kohën e punës me kohën e keqardhjes e të pendimit.

Si ndërtohet e ardhmja? Duke menduar për të ardhmen apo duke punuar për të tashmen? Duke punuar për të tashmen ndërtohet e ardhmja.

Hasan El-Basriu ka thënë: “Ruajuni nga zvarritja. Ti ke vlerë për shkak të ditës së sotme, jo për shkak të së nesërme!”¹

Abdullah ibn Omeri (r.a) ka thënë: “Kur të ngrysesh, mos e prit mëngjesin dhe kur të zgjohesh në mëngjes, mos e prit mbrëmjen!”²

Ebu Bekri (r.a) në momentet e vdekjes e këshilloi Omerin (r.a) me këto fjalë: “Allahu ndaj teje ka kërkesa gjatë ditës që nuk i pranon natën dhe ka kërkesa gjatë natës që nuk i pranon ditën. Andaj, punën e ditës mos e lër për natën dhe punën e natës mos e lër për ditën. Çdo kohe jepja hakun siç duhet!”

Allahu (xh.sh) thotë: “Namazi është obligim për besimtarët në kohë të caktuar!”³

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi

1. Ibn Mubarek, “Ez-Zuhd”, 7.
2. Transmeton Buhariu, 6416.
3. Kur’ani, En-Nisa: 103.

të) i jep pesë këshilla shumë të çmuara një shoku të tij dhe jo vetëm atij, por çdonjërit prej nesh: “Shfrytëzo pesë gjëra, para se të të vinë pesë të tjera: rininë para se të plakesh, shëndetin para se të sëmuresh, pasurinë para se të të vijë varfëria, kohën e lirë para se të jesh i zënë, dhe jetën para se të të vijë vdekja”.⁴ Nëse sot je nxënës, mëso! Nëse sot je i shëndetshëm, puno! Lerë merakun e së nesërme.

Hasan El-Basriu ka thënë: “Nxito përpara se të të vijë fundi. Mos thuaj “nesër, nesër”, sepse ti nuk e di se kur do të shkosh te Zoti!”.

Një njeri ka shkuar tek Pejgamberi (a.s) dhe e ka pyetur: “Kur do të ndodhë Kiameti?” Profeti (a.s) i është përgjigjur: “Çfarë ke përgatitur për atë ditë?”⁵

Ibn Ajash thoshte: “Nëse dikujt i humbet një dërm (monedhë argjendi), ai e kalon gjithë ditën duke u ankuar: “O Zot o Zot, më humbi dërmehi!” Por, kur i humbet jeta, nuk thotë asgjë. Nuk thotë: “Më humbi jeta!”

Muslimanët e parë, kur e lavdëronin dikë si njeri të mirë dhe të devotshëm, thoshin: “Nëse do t’i thuhej se nesër ke për të vdekur, ai nuk ka çfarë të shtojë më shumë nga ajo që tashmë ka bërë!” Kjo do të thotë se ai ka qenë gjithmonë i përgatitur, duke jetuar çdo ditë me vetëdijen se mund të jetë e fundit dhe duke mos lënë asgjë për nesër.

4. Hadith i saktë. Transmeton Hakimi, Bejhaku në “Shuabul-Iman” dhe Ibn Ebi Dunja në “Kasrul-Emel”.

5. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

BAMIRËSI SAUDIT, ZAMIL IBN ABDULLAH EZ-ZAMIL URON MYFTIUN E SHKODRËS ME RASTIN E 30-VJETORIT TË XHAMISË “EBU BEKËR”

Pas lajmit të shpërndarë nga faqja zyrtare e Myftinisë Shkodër, më 27 tetor 2025, ku informon opinionin publik me rastin e 30-vjetorit të përvitimit të xhamisë së madhe të Shkodrës në Fushë Çelë, që tashmë mban emrin e Sahabiut të dashur, Hz. Ebu Bekri (r.a) dhe jehonës që bëri ky lajm edhe në media të ndryshme në gjuhën arabe, ditën e sotme, e mërkurë, 29 tetor 2025, bamirësi saudit Zamil ibn Abdullah Ez-Zamil, i ka dërguar një shkresë falënderimi Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ku ndër të tjera thekson:

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Shejkh i nderuar, Myftiu i Qarkut të Shkodrës – Allahu e ruajtë!

Es-Selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuh

E kemi ndjekur me vëmendje prononcimin tuaj të publikuar me rastin e 30-vjetorit të përfundimit të ndërtimit të xhamisë së madhe, “Ebu Bekër Es-Siddik” në zemër të qytetit të Shkodrës.

Na gëzon fakti që, nga Mbretëria e Arabisë Saudite, t’ju shprehim mirënjohjen tonë të singertë për fjalët tuaja të bukura dhe për përpjekjet e singerta që bëni në shërbim të Islamit dhe myslimanëve në Shqipëri.



Përmendja juaj e xhamisë, e historikut të vakëfit dhe e veprës bamirëse, si dhe ajo që përmbante prononcimi juaj lidhur me kujdesin për pasuritë dhe vakëfet e myslimanëve, kanë lënë një përshtypje shumë të mirë në zemrat tona.

E konsiderojmë këtë xhami dhe gjithçka që ka ardhur pas saj — nga frytet e dijes, thirrjes dhe përkushtimit në rrugën e drejtë — si një sadaka rrjedhëse, që lusim Allahun ta pranojë me një pranim të bukur dhe ta bëjë shkak për gjallërimin e jetës së besimit në ato troje.

Lusim Allahun t’ju japë ndihmë e sukses të vazhdueshëm, që kjo xhami e bekuar të vazhdojë misionin e saj në përhapjen e udhëzimit dhe dijes, t’i

bekojë veprat tuaja, t’ju shpërblejë me të mira dhe t’i shkruajë përpjekjet tuaja në peshoren e veprave të mira.

Zamil ibn Abdullah Ez-Zamil

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Myftinia Shkodër falënderojnë pafundësisht kontributin e çmuar të familjes Ez-Zamil për ndërtimin e xhamisë së madhe në zemër të Shkodrës, me lutjet e përzemërta, që kjo xhami të ngelet një pikë referimi për Shkodrën duke u rritur ditë pas dite në nivelet më të larta të një vatre udhëzimi drejt dritës së tabanit, traditës dhe vlerave të mira islame dhe qytetare në Shkodër dhe përtej.

REPUBLIKA ARABE E SIRISË NJEH ZYRTARISHT KOSOVËN SI SHTET TË PAVARUR

Nën kujdesin e Mbretërisë Arabe Saudite dhe me mbështetje nga Republika e Turqisë, Republika Arabe Siriane lajmëroi sot, më 29 tetor 2025, njohjen e saj zyrtare të Republikës së Kosovës si një shtet i pavarur.

Këtë e bëri të ditur Ministri i Jashtë i Republikës Arabe të Sirisë, Es’ad Hasen Esh-Shejbani, në një postim zyrtar në platformën ‘X’, datë 29 tetor 2025.

Lajmi i njohjes së Republikës së Kosovës nga Republika Arabe e Sirisë është një moment i gëzueshëm për çdo shqiptar, si dhe dëshmi e vëllazërisë dhe bashkëpunimit të vjetër e të singertë ndërmjet dy popujve tanë përgjatë rrjedhave të historisë së njerëzimit.

Vlen të theksohet se komuniteti

shqiptar, arnautët janë banorë të respektuar dhe të nderuar në Republikën Arabe të Sirisë. Ata kanë dhënë kontribute të çmuara për Sirinë, që nga momenti i parë i emigrimit të tyre në këtë vend të bekuar.

Për Myftininë e Shkodrës dhe qytetin tonë, Siria dhe kryeqyteti i saj Damasku në veçanti, kanë një vend të veçantë në

memorien tonë kombëtare, pasi Damasku është vendi ku shumë familje të nderuara shkodrane emigruan në periudhën e fillim shekullit të 20-të.

Allahu të Madhëruar i lutemi që të begatojë dy popujt tanë dhe dy vendet tona, e mbarë njerëzimin duke i udhëhequr të gjithë pa përjashtim drejt paqes, harmonisë dhe mirëqenies.





Arben Halluni, teolog

Një kategori e dijetarëve e lidhin njeriun me totemizmin dhe fenë, duke menduar se totemizmi është burimi i feve të para. Sa për njohuri; Totemizmi është një besim fetar ose shoqëror i lashtë, sipas të cilit një grup njerëzish (zakonisht një fis ose klan) ka një lidhje shpirtërore, simbolike ose hyjnore me një totem që mund të jetë një kafshë, bimë ose objekt natyror.

Është vërtetuar se shenjat e totemizmit janë të përhapura mes qindra fiseve primitive në Australi, Amerikë dhe disa pjesë të Azisë dhe ishujt e saj.

Në këto fise, secila prej tyre ka një totem të madh që e nderon, shpesh një kafshë e madhe apo e vogël, e cila bëhet shenjë e saj më e lartë dhe më e shenjtë. Kështu, kur totemi është një bimë apo një pemë, ata e konsiderojnë të ndaluar ta prekin ose ta dëmtojnë, dhe e shohin si të shenjtë sikur të ishte një pjesë e shpirtave të tyre.

Nëse, fisi merr si totem të tij një kafshë, atëherë e ndalon vrasjen dhe ngrënien e saj në shumicën e rasteve. Po ashtu ndalon martesën mes meshkujve

TOTEMIZMI HISTORIA E NJERIUT QË KËRKONTE HYJNOREN

dhe femrave që i përkasin të njëjtit totem, edhe nëse janë të largët.

Në fiset e mëdha, ku ka shumë toteme, ndodh që ata të ndalojnë martesën brenda të njëjtit totem, por e lejojnë martesën mes pjesëtarëve të totemeve të ndryshme.

Dhe nga kjo thjeshtësi rrjedh kjo ide se shpirti nuk ka qenë fillimisht themeli i besimit fetar, sepse përhapja e idealeve dhe respektimi i tyre në sistemet e martesës, rregullat e marrëdhënieve dhe edukatën shoqërore, nuk janë veçse faza e parë e zhvillimit të besimit.

Nuk ka dyshim se njerëzit nuk e quajtnë atë “shpirt” porse e panë atë si një trup që hyn në kafshë ose në njeriun dhe e lë atë me vdekjen, ashtu siç është edhe shenjtërimi i armëve para se ata t'i njihnin ato, dhe shumë zakone të tjera që dolën nga mendimi i thjeshtë dhe u shtrinë në mënyrë absolute. Për këtë arsye, shfaqjet fetare nuk dalin jashtë këtyre kufijve të thjeshtësisë mendore.

Shkolla franceze e “Dyrkheim”-it e kthen çështjen e besimit fetar në burimin e saj shoqëror/shoqëria në tërësi, ndërsa një shkollë tjetër e redukton atë në një individ të caktuar si burim, në një gjenitë të posaçme të pajisur me ndriçim dhe përvojë të brendshme.

Nga ana tjetër, thelbi i fesë shoqërore është një “ndërgjegje kolektive”, të cilën imagjinata e njeriut e ndërtoi për të ruajtur interesat e tij në shërbim të përfitimeve më të mëdha që lidhen me gjininë e tij. Njeriu, po të mbështetej vetëm te mendja e tij dhe të ishte i mbyllur brenda vetes, do të shkatërrohej, prandaj instinkti i jetës e

bëri atë të punojë për hir të pasardhësve të tij. Dhe meqenëse instinkti i jetës është një instinkt i rrezikshëm, i prirur të kthehet kundër vetë gjinisë, u formua përballë tij një “fuqi e shenjtë”, e cila është si një mbret që sundon gjininë me anë të miteve dhe besimeve. Ajo e detyron njeriun të heqë dorë nga interesat e tij të veçanta për të mirën e përgjithshme të gjinisë së tij.

Kështu u formua zakoni i detyrueshëm, që e detyron individin të sakrifikojë për gjininë, duke u bazuar në idenë se e mira e përgjithshme është e lidhur ngushtë me të mirën e tij personale. Kështu u ruajt baraspesha ndërmjet interesit të individit dhe interesit të gjinisë, duke përfunduar në përputhjen midis interesave të tij dhe interesave të shoqërisë.

Ndërsa thelbi i fesë tek individit i veçantë është frymëzimi ose zbulësia, ku njeriu lidhet me një forcë krijuese të brendshme ose me një “shtysë jete” siç e quan Bergson (Elan Vital).

Kjo shtysë jetësore u zhvillua deri sa arriti tek filozofët, të cilët e quajtnë atë me shprehje të tjera si “vetë hyjnore” e cila nuk ndryshon e nuk shndërrohet, edhe pse është e ndarë nga këto ekzistenca. Ajo është një frymë që i jep jetë, ose e plotëson dhe e shpjegon atë që ndodhet në fillimin e krijimit të gjigantëve shpirtërorë, të cilët janë të përjetshëm siç mendojnë filozofët, ose siç mendojnë ithtarët e tyre se ata nuk janë të kufizuar nga mendja dhe se studimet psikologjike e shkencore nuk e arrijnë dot thelbin e tyre, sado të përpiqen...

-vazhdon...



H. Sadush ef. Tahiri

Ligjërues islam, Shkup

Kurrë mos i nënvlerëso gjërat e vogla, sepse ndoshta mu në ato janë vendosur sekretet më të mëdha të Allahut, që ti vonë do t'i kuptosh ndoshta..., pas një jete të gjatë bile...

- Mos mendo se gjërat në këtë botë nuk kanë çmim! Të gjitha kanë çmim të shtrenjtë bile; kujdesi i prindërve, bashkëshortit, etj...

- Mos harro se këmisha e Jusufit ishte vetëm këmishë, por ajo në fillim ishte mërzë, e pastaj u bë gëzim, në fillim mashtrim, por në fund shfaqje, arsyetim dhe pendim, në fillim gënjeshtëri, por në fund besnikëri... ishte vetëm këmishë!

- Ndodh të jetosh në shtëpi të vogël, por me shumë bereqet dhe ndikim të madh, lumturi e hare, sot kanë pallate e lukse, por aspak të lumtur. Ka që flenë në hotele me 7 yje, por hoteli i hanë për së gjalli, krijon zjarr në trup e shpirt, ndërsa ti mund të jesh në pushim me të dashur në një shtëpi të vogël, por gjithë lumturi.

NDOSHTA TË DUKEN TË VOGLA, POR...

Ndodh të jetosh në shtëpi të vogël, por me shumë bereqet dhe ndikim të madh, lumturi e hare, sot kanë pallate e lukse, por aspak të lumtur. Ka që flenë në hotele me 7 yje, por hoteli i hanë për së gjalli, krijon zjarr në trup e shpirt, ndërsa ti mund të jesh në pushim me të dashur në një shtëpi të vogël, por gjithë lumturi.

- Mos harroni se Pejgamberi (a.s) rekomandoi çdo natë të lexohet surja El-Vakia, sepse garanton rizkun dhe mirëqenien, kjo sure është sikur kompani sigurimi (lexojeni)!

- Ndonjëherë na vijnë porosi nga qielli, i llogarisim të vogla, por janë frymëzim nga Allahu.

- Ndoshta është e vogël të vdesësh në vendin tënd, por shumë e madhe kur dikush në anën tjetër të botës ta fal xhenazen në mungesë.

- Sadakaja ndodh të jetë vetëm 1 euro, shumë pak, por te Allahu e madhe, buzëqeshja nuk kushton asgjë, por tek Allahu fitohet xheneti, etj.

- Varri për dikë është vetëm gropë, ama për të diturin është gosti e Allahut dhe dritë.

- Dy reqate janë pak (vetëm 5 min), por krijojnë mrekulli, mrekulli, mrekulli.

- Njeriu më i mirë është ai që është më i lehtë për njerëzit (hadith), me gjëra të vogla..

- Rizku nuk është paraja, por rehatia në zemër, dashuria e njerëzve, vlerësimi

i fëmijëve për ty.

- Dijeni se kur njeriu vdes, katër gjëra nëse dëshmojnë për të, Allahu kurrë nuk e turpëron: grua/burri (për njëri tjetrin), fëmijët, të afërmit dhe trupi yt. Nëse këta nuk dëshmojnë për ty, mjerë ti dhe unë..

- Rizku nuk kërkohet, rizku kuptohet, rrallë janë ata që e kuptojnë sot rizkun, e kërkojnë vetëm. Ah sikur ta kuptojmë, e këtë vetëm Allahu e mundëson.

- Musai (a.s) jetoi në pallat, por kurrë nuk ishte i lumtur, e i lumtur u bë kur jetoi në kasolle, por e gjeti gruan e vyeshe! Dashurohuni në mendje jo në trup.

- Junusi (a.s) ishte në barkun e peshkut, por e shpëtoi vetëm TESBIHU. Gjë e vogël ama krijoi zhurmë në qiell.

- Zekerija (a.s) kërkoi fëmijë, por këtë e bëri vetëm me një fjalë! Një fjalë ishte, por ndikoi shumë tek Allahu.

- Mos harroni pra, se gjëra të vogla, por plot sekrete në të.

Kjo mund të vazhdojë edhe më tej... ju lë ju të mendoni!



MOZAMBIKU OSE REPUBLIKA E MOZAMBIKUT

Mozambiku, zyrtarisht Republika e Mozambikut, është një vend që gjendet në Afrikën Juglindore, i kufizuar nga Oqeani Indian në lindje, Tanzania në veri, Malavi dhe Zambia në veriperëndim, Zimbabve në perëndim dhe Esvatini dhe Afrika e Jugut në jug dhe jugperëndim. Shteti sovran është i ndarë nga Komoret, Majota dhe Madagaskari përmes kanalit të Mozambikut në lindje. Kryeqyteti dhe qyteti më i madh i vendit është **Maputo**.

Mozambiku ka një sipërfaqe prej 801,590 km², dhe një popullsi prej 34,777,605 banorësh (viti 2024).

GJEOGRAFIA

Mozambiku ndodhet në bregun juglindor të Afrikës. Vendi ndahet në dy rajone topografike nga lumi Zambezi. Në veri të Zambezit, brezi i ngushtë bregdetar i hap rrugën kodrave të brendshme dhe pllajave të ulëta. Malësitë e ashpra janë më në perëndim; ato përfshijnë malësitë Niassa, malësitë Namuli ose Shire, malësitë Angonia, malësitë Tete dhe pllajën Makonde. Në jug të Zambezit, ultësirat janë më të gjera, me pllajën Mashonaland dhe malet Lebombo që gjenden më në jug.

Vendi përshkohet nga pesë lumenj kryesorë dhe disa më të vegjël, më i madhi dhe më i rëndësishmi nga të cilët është lumi Zambezi. Vendi ka katër liqene të shquara: Liqeni Niassa (ose Malavi), Liqeni Çiuta, Kahora Bassa dhe Liqeni Shirva, të gjithë në veri.

Qytetet kryesore në vend janë: Maputo, Beira, Nampula, Tete, Quelimane, Çimoio, Pemba, Inhambane, Shai-Shai dhe Liçinga.

KLIMA

Mozambiku ka një klimë tropikale me dy stinë: një stinë me shi (tetor – mars) dhe një stinë të thatë (prill – shtator). Megjithatë, kushtet klimatike ndryshojnë në varësi të lartësisë. Reshjet janë të dendura përgjatë bregdetit, dhe zvogëlohen në veri dhe jug në brendësi të vendit. Reshjet vjetore variojnë nga 500 deri në 900 mm, në varësi të rajonit, me një mesatare prej 590 mm. Ciklonet janë të zakonshme atje gjatë stinës me shi. Temperatura mesatare në Maputo sillet rreth 13 - 24 °C në korrik, dhe 22 - 31 °C në shkurt.

EKONOMIA

Dy komponentë të rëndësishëm të ekonomisë së Mozambikut janë eksportet bujqësore dhe aktivitetet portuale. Produktet kryesore të vendit janë misri, bananet, meli, manioka, kikirikët, kallam sheqeri, kërpi, pambuku, duhani, çaji, orizi dhe kokosi. Blegtoria përbëhet nga gjedhët, delet, dhitë dhe derrat. Disa fise që jetojnë në rajonin e poshtëm të Zambezit merren me peshkim, në shkallë të vogël.

Burimet minerale të vendit përfshijnë argjendin, asbestin, boksitin, berilin, qymyrin, kolumbitin, grafitin, mikën, litiumin, arin, kripën, turmolinën dhe

mallrave të përpunuara dhe pajisjet e transportit.

Turizmi, veçanërisht i zhvilluar në rajonin e Maputos, mban një vend të rëndësishëm midis burimeve të të ardhurave të vendit.

GJUHA

Në Mozambik numërohen rreth 46 gjuhë të folura, por e vetmja gjuhë zyrtare atje është portugalishtja, e cila flitet në zonat urbane si gjuhë e parë ose e dytë nga shumica, dhe në përgjithësi si 'lingua franca' midis mozambikasëve të rinj me qasje në arsimin formal. Gjuhët më të rëndësishme lokale janë



uraniumin, e megjithatë, këto nuk shfrytëzohen siç duhet. Jeta ekonomike është më e zhvilluar rreth hekurudhave nga Afrika e Jugut, Zimbabve dhe Malavi. Maputo - porti më i rëndësishëm në vend - është gjithashtu një qendër industriale, ku ndodhen fabrika të përpunimit ushqimor, fabrika birre, fabrika vaji dhe sapuni, si dhe dyqane të vogla përpunimi metalesh. Mozambikut i mungon një ekonomi e fortë, kështu që banorët vendas detyrohen të udhëtojnë për punësim në vendet fqinje më të pasura, si në Afrikën e Jugut dhe në Zimbabve.

Mallrat kryesore bujqësore të eksportit janë pambuku, kokosi, kërpi dhe sheqeri, kurse ato të importit janë tekstilet, ushqimet, kimikatet, produktet metalike, të gjitha llojet e

Tsonga, Makhuvu, Sena, Çiceva dhe Suahili. Suahili – një kombinim fjalësh nga arabishtja dhe komunitetet Bantu-folëse të Afrikës Lindore - flitet në pjesët veriore të vendit, përgjatë bregdetit, dhe në ishullin e Mozambikut.

FEJA

Sipas regjistrimit të vitit 2020, katolikët përbënin 27 % të popullsisë, protestantët 35%, muslimanët përbënin 20% të popullsisë (afërsisht 7 milion njerëz), 4 % e njerëzve raportuan se praktikonin besime të tjera, kryesisht animizëm, dhe 14 % nuk kishin besime fetare.

HISTORI

Njerëzit e parë që banuan në Mozambik ishin ata Khoi-khoi dhe San. Mes viteve 200 - 300 e.j. Bantu, një

grup i përbërë nga etni të ndryshme, por me karakteristika të ngjashme, migroi nga Liqeni i Madh në Veri, dhe i shtyu vendasit në zonat më të varfra në Jug.

Nga fundi i shekullit të 6-të e.j, komuniteti suahili-arab krijuan pika tregtare për të tregtuar ar, bakër dhe hekur.

Në shekullin e 15-të në Mozambik arritën portugezët. Nga viti 1502 deri në mesin e shekullit të 18-të, interesat portugeze në Mozambik kontrolloheshin nga administrata portugeze në Indi. Që në fillim, portugezët ndërtuan "feitorias" ose: pika tregtare. Këto u pasuan nga fortesa e Sofalas, e ndërtuar në vitin 1505 në bregdet, dhe fortesa në 'Ilha de Mozambique' e ndërtuar në vitin 1507.

Disa vite më vonë, në një përpjekje për të marrë nën kontroll zonat prodhuese të arit, ata u futën në brendësi të vendit dhe krijuan zona të reja tregtare. Këto zona tregtare u pasuan - në fund të shekullit të 17-të në 'Vale do Zambeze' - nga "prazos" ose 'prona bujqësore private'. Këto toka u dhuruan ose u pushtuan, sipas rastit. Kjo periudhë mund të konsiderohet si fillimi i kolonizimit portugez në Mozambik.

Në vitin 1832, "prazos" u ndërpre me dekret mbretëror, dhe me shfaqjen e feudeve nisi tregtia e skllëvërve, e cila vazhdoi deri madje edhe pas heqjes së skllavërisë në Koloni, në vitin 1869. Ndarja e Afrikës midis fuqive evropiane, e përcaktuar në Konferencën e Berlinit të viteve 1884-1885, i obligoi portugezët t'i mbanin nën pushtim të vazhdueshëm territoret që u ishin caktuar atyre.

Vështirësitë financiare dhe ushtarake e bënë të pamundur për Portugalinë të mbante pushtimin e Mozambikut, si pasojë, sipërfaqe të mëdha toke iu dhanë me qira kompanive private, të cilat u bënë të njohura për praktikën e punës së detyruar. Këto kompani kontrollonin burimet bujqësore, si dhe punën e krahut deri në vitet 1930.

Pushtimi kolonial nuk ishte kurrë një proces paqësor. Represioni dhe shfrytëzimi provokuan një reagim të ashpër që çoi në rritjen e lëvizjes për pavarësi dhe themelimin e organizatave për liri si 'Frelimo' (në vitin 1962), dhe lufta e armatosur bëri që më 25 qershor të vitit 1975 vendi të fitonte pavarësinë. Një luftë civile 17-vjeçare që shpërtheu më pas u zgjidh vetëm në vitin 1992. Zgjedhjet shumëpartiake u mbajtën më pas në tetor të vitit 1994, dhe 'Frelimo' doli fitues.

Në vitin 1995 Mozambiku iu bashkua



Komonuelthit, dhe filloi përpjekjet për të promovuar investimet e huaja dhe turizmin.

ISLAMI NË MOZAMBIK

Muslimanët kanë jetuar në brigjet e Mozambikut - si dhe në të gjitha brigjet e Afrikës Lindore - që nga shekulli i 8-të e më pas.

Me vendosjen e sundimit kolonial portugez, priftërinjtë jezuitë që mbërritën në rajon u angazhuan në kristianizimin e muslimanëve dhe të popullsisë indigjene në Luabo, Quelimane, Tete dhe ishullin e Mozambikut.

Përhapja e Islamit midis vendasve në brendësi të vendit filloi kryesisht në fillim të shekullit të 18-të, me anë të muslimanëve që portugezët i sillnin nga India. Megjithatë, numri në rritje i muslimanëve e shqetësoi administratën koloniale portugeze dhe emigracioni u kufizua.

Rreth vitit 1750, muslimanë të shquar indianë hapën një shkollë kur'anore në Inhambane, në bregdet, dhe filluan të ofronin arsim islam. Në vitin 1770, në Macuana filloi një përhapje e madhe e Islamit. Hapja atje e xhamive të reja për adhurim, e shqetësoi administratën portugeze.

Në fillim të shekullit të 19-të, në Cabo Delgado jetonin rreth 50,000 muslimanë, ndërsa në kontinentin e Mozambikut jetonin 20,000 -30,000.

Dinastia Bu Said, e cila e zhvendosi selinë e saj të pushtetit nga Muskati - kryeqyteti i Omanit - në Zanzibar, luajti një rol të rëndësishëm në rritjen e popullsisë muslimane në atë rajon. Dinastia, një rivale e madhe ndaj kolonializmit portugez në Afrikën Lindore, vendosi dominimin e saj përgjatë bregdetit nga Mombasa në Kilëa, duke sjellë lehtësim për muslimanët e

Afrikës Lindore. Kilëa rifitoi rëndësinë e saj, siç kishte bërë para shekullit të 16-të. Kjo kontribuo në ringjalljen e jetës fetare dhe tregtare të muslimanëve mozambikas në jug të qytetit. Gjatë së njëjtës periudhë, Angoche u bë qendra më e rëndësishme e rajonit pas Kilva-s. Kur tregtia e skllëvërve u ndalua në vitin 1836, muslimanët filluan të predikonin në mesin e grupit etnik Makua që jetonte në rajonet pranë bregdetit dhe konvertuan një pjesë të konsiderueshme të tyre në Islam.

Në vitin 1866, një pjesë e konsiderueshme e grupit etnik Makonde në Mozambikun verior, që jetonte në zonat bregdetare, ishin muslimanë. Eltoni (James Frederic Elton), i cili vizitoi brendësinë e Mozambikut mes viteve 1875 - 1876, vuri re se Islami ishte përhapur në shumë pjesë të vendit. Pasi Mekanjila Banali III, kreu i Yao, një grup i madh etnik që jetonte në kufirin e përbashkët të Tanzanisë, Malavit dhe Mozambikut, u konvertua në Islam, në vitin 1870, vendbanimet nën administrimin e tij u bënë qendra të thirrjes Islame. Dijetarët muslimanë kontribuan ndjeshëm në përhapjen e Islamit në Mozambik, mes viteve 1910 - 1920.

Muslimanët mozambikas ishin gjithashtu në kontakt me Perandorinë Osmane. Ebu Bekr Efendiu, i dërguar në Afrikën e Jugut në vitin 1862, për të predikuar dhe udhëhequr, e vizitoi Mozambikun disa herë. Gjatë ndërtimit të hekurudhës Hamidije-Hixhaz (hekurudha që lidhte Turqinë me Vendet e Shenjta Islame – Mekën dhe Medinen - në Arabinë Saudite), ndihma financiare e mbledhur nga Këshilli Islam në 'Lourenço Marques' (Mozambik) u dërgua në Stamboll, dhe muslimanët mozambikas që kontribuan u vlerësuan më pas me medalje nga Abdulhamidi i 2-të.

XHAMIA XHUMA (1889), MAPUTO



Në fillim të shekullit të 20-të, Angoche, një nga qendrat kryesore islame të Mozambikut, krenohej me pesëmbëdhjetë xhami dhe shkolla kur'anore. Administrata koloniale portugeze u shqetësua nga ky gjallërim i jetës fetare islame. Në vitin 1903, shtëpitë dhe xhamitë muslimane ishin shkatërruar dhe plaçkitur. Pavarësisht kësaj, studiuesit komorianë vazhduan të vinin në Angoche për të dhënë mësim mbi ligjin islam dhe gjuhën arabe.

Administrata koloniale portugeze, e cila në vitin 1937 i kishte mbyllur të gjitha xhamitë dhe shkollat kur'anore në bregdetin e Mozambikut, e ndryshoi këtë vendim vitin pasardhës nën presionin e muslimanëve. Sipas Atlasit Misionar Portugez, në vitin 1964, në vend kishte 800 000 muslimanë, 796 403 katolikë dhe 200 000 protestantë. Përveç kësaj, afërsisht 10 000 muslimanë me origjinë indiane kishin jetuar në Mozambik për shumë vite.

Dekada e parë pas pavarësisë ishte një periudhë shumë e vështirë për muslimanët mozambikas. Në vitin 1976, pasi Fronti Çlirimtar i Mozambikut i ndaloi shoqatat fetare në vend, studentët muslimanë mozambikas që studionin në Dar Es-Salam e ngritën çështjen ndërkombëtarisht, duke deklaruar se Islami po i nënshtrohej një presioni të tepruar në vendin e tyre. Fronti Çlirimtar i Mozambikut e njohu zyrtarisht Këshillin e Muslimanëve të Mozambikut (CISLAMO) në vitin 1983. Megjithatë, muslimanët u përjashtuan nga qeveria deri në vitin 1989 për shkak të bashkëpunimit të tyre të dyshuar me Arabinë Saudite dhe Omanin.

Në vitin 1990, u krijua një organizatë e re - Congresso Islamico - për t'i bashkuar muslimanët nën një ombrellë të vetme administrative. Zgjedhjet

shumëpartiake në vitin 1993 sollën njëfarë lehtësime në jetën fetare në Mozambik.

Lidhur me përqindjen e popullsisë muslimane të Mozambikut, të përqendruar kryesisht në veri, jepen shifra të ndryshme: 20-30%. Disa studiues muslimanë sugjerojnë se kjo shifër e tejkalon 50%, por se është nënvlerësuar për arsye fetare dhe politike. Pothuajse të gjithë muslimanët suahili që jetojnë në rajonin bregdetar janë sunitë të shkollës Shafi'i, ndërsa ata nga India janë sunitë të shkollës Hanefi. Muslimanët praktikisht nuk kanë asnjë të drejtë fjale në qeveri, dhe që nga viti 1990, vetëm një ministër musliman i ka përfaqësuar ata në kabinet. Mozambiku u bë anëtar i plotë i Organizatës së Bashkëpunimit Islam në vitin 1994, falë iniciativave të Joseph Abboud, ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe çështjet fetare. Një vit më vonë, Mozambiku u pranua në Bankën Islame të Zhvillimit.

Në vitin 1994, rivaliteti midis Frontit Çlirimtar të Mozambikut dhe Rezistencës Kombëtare të Mozambikut i çoi këto dy parti të konkurronin për kandidatë të shquar muslimanë në listat e tyre. Partia e Pavarësisë së Mozambikut (PIMO) e themeluar nga muslimanët mori vetëm 1% të votave. Me iniciativën e parlamentarëve muslimanë, Kurban Bajrami u njoh si festë zyrtare vetëm në vitin 1996. Në vitin 2000, në Mozambik u hap 'Universiteti Musa ibn Bik', për të ofruar mundësi të arsimit Islam të nivelit të lartë për të rinjtë muslimanë.

Përgatiti:

Msc. Arta ujka, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://ambassademozambiquefrance.fr>
<https://www.mozambique.co.za>
<https://www.britannica.com>
<https://islamansiklopedisi.org.tr>

MYFTIU I SHKODRËS PRITI PËR VIZITË ISH ARQIPESHKVIN E SHKODRËS, MONS. MASSAFRA



Paraditen e së enjtes, më 30 tetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim kortezie, Mons. Angelo Massafra, ish arqipeshkv i Shkodrës, i cili ndodhet për një vizitë disa ditore në Shkodër.

Gjatë vizitës së përzemërt dy bashkëbiseduesit u ndalën në një sërë çështjesh me interes të përbashkët, ku theksi i vu tek angazhimet e mëdha të dy komuniteteve fetare, atij musliman dhe atij katolik, në shërbim të njerëzve në nevojë dhe në përpjekjet e vazhdueshme për përhapjen e vlerave qytetëruese të besimit dhe të fesë.



U soll në vëmendje gangrena e grabitjes së pronave të komuniteteve fetare, mosrespektimi i ligjeve dhe abuzimi me të drejtën e komuniteteve në vende dhe kohë të ndryshme, ku u përmend edhe rasti flagrant i ndërtimit të kullës në vakëfin e Fushë Çelës.

Nga ana e tij, Myftiu Sytari falënderoi vizitorin e çmuar për vizitën duke theksuar se Mons. Massafra me kontributet dhe angazhimin e tij mbetet përherë një mik i mirë dhe një qytetar i nderuar i Shkodrës.

Ndërkohë, Mons. Massafra shprehu dëshirën për vizitën e kompleksit të xhamisë së Plumbit në kuadër të 35-vjetorit të rihapjes së kësaj xhamie.

Bisedat me vlerë vazhduan edhe më tej duke nxjerr në pah rëndësinë që kanë këto takime dhe frymën e bashkëpunimit, që komunitetet fetare kanë ndërmjet vete.



Evans Driшти

Mësues - Medreseja "H. Sheh Shamia"

Ti nuk më kupton!

Ti nuk më kupton, pasi nuk më mësove se si bëhet gjuetia.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më orientove si kryhet peshkimi.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më zhdërvjelltësove të kapja fluturat në mesin e një fushe gjelbëroshe

Ti nuk më kupton, pasi nuk pranove të bashkëargëtoheshim me lojërat e vegjëlisë.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më përfshive në botën magjepsëse të përrallave dhe fabulave, që të bëheshim personazhe të pashtershëm.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më kërkove të ujisja lulet ndër saksia.

Ti nuk më kupton, pasi nuk tentove të më nxisje të vadisim bimët në kopshte.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më drejtove të gjykoja si krasitet bari i njomë

Ti nuk më kupton, pasi nuk më nxite të fokusohesha tek mbajtja në rregull e gjilpërës për të qepur majën e shqyer të çorapit

Ti nuk më kupton, pasi nuk më nxite të dëshiroja të luaja kukafshehti në korridoret e shtëpisë apo të oborrit.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më ambientove të mbihja tokën apo të plugoja dheun e njomë.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më kërkove të laja enët e palara si për angazhim.

Ti nuk më kupton, pasi nuk tentove, qoftë edhe një herë të vetme të bashkëlexojmë një tregim.

Ti nuk më kupton, pasi nuk arrite të më japësh në dorë një çekiç dhe një gozhdë, qoftë edhe për të stolisur bashkërisht murin e shtëpisë apo të shkollës.

Ti nuk më kupton, pasi nuk më afrove

TI NUK MË KUPTON!

drejt zdrukthtarisë, që të prekja dhe të ndjeja kënaqësinë që të ofron e drunjta,

Ti nuk më kupton, pasi nuk reshte së dhëni me tepri materialisht, që unë të ndjehesha mirë.

Ti nuk më kupton, pasi s'arrite të uleshe me mua të ndanim një bashkëlexim për lëndët shkollore apo për temat sociale e kulturore.

Ti nuk më kupton, pasi s'ngriheshe fare nga tryeza e sulltanatit profesional, që të më hetoje nga afër relativitetin e shpirtërores sime.

Ti nuk më kupton, pasi s'arrite ta përvetësoje kurrë empatinë të zbrisje në moshën time, që të bashkëgëzoje apo bashkëvuaje me mua në çaste të ndryshme.

Ti nuk më kupton, pasi u fshehe gjithnjë në këshillin pedagogjik apo në zyrën tënde në ato pushimet e vogla dhe të mëdha duke mos ndarë me mua momente reflektimi apo edhe bashkëngrënieje.

Ti nuk më kupton, pasi ngurove të nxirrje në pah mendjen dhe urtësinë time për t'u zhvilluar në një sferë për të arritur në pedestal.

Ti nuk më kupton, teksa më shihje me shikime qortuese, sa herë mbaja në dorë një gërshërë duke prerë fletëza të ndryshme, në përpjekje për t'u argëtuar, pasi më kishte hequr lojën e fëmijërisë sime.

Ti nuk më kupton, pasi, ndërsa unë hidhja shtat, ti shpejtoje nëpër kafenetë e qytetit duke u marrë me thashethemnajën e rrëmujshe, e harroje të rriteshe me mua.

Ti nuk më kupton, pasi refuzove të më qëndroje pranë, sa herë që më duhej të interpretoja një pjesë që më ishte kërkuar nga mësuesi apo të plotësoja qoftë edhe një detyrë të thjeshtë.

Ti nuk më kupton, pasi turpëroheshe të interesoheshe, lëre pastaj edhe të diskutoje për ndryshimet e mia hormonale.

Ti nuk më kupton, pasi s'arrije të më shihje drejt e në sy, sa herë që isha i brengosur apo i tronditur.

Ti nuk më kupton, pasi sa herë tentoj të flas me ty, qoftë edhe për diçka të bukur, zmbropsesh e nis të bërtasësh me atë autoritetin tënd të kripur dhe pa sens.

Ti nuk më kupton, pasi s'more guximin, qoftë edhe një herë të vetme të më marrësh për dore për të parë një shfaqje të bukur në teatër, një film në kinema, një ekspozitë në galeri të arteve, një promovim libri, një event familjar apo shoqëror.

Ti nuk më kupton, pasi të vjen e tepërt të flasësh me mua në intervale kohe të ndryshme apo qoftë edhe të më telefonosh thjesht për kënaqësi në mungesën tënde fizike.

Ti nuk më kupton, pasi trembesh të më buzëqeshësh në një orë mësimore, apo kur hy në shtëpi.

Ti nuk më kupton, sa herë që bëj një shaka në shkollë apo në shtëpi, në rrugë apo kudo tjetër, teksa vrapoj kërcimthi në përpjekje të një argëtimi, teksa përpiqem



të të rrok, e ndërkaq kundërvepron pa sens me paragjykimin e një bullizimi.

Ti nuk më kupton, teksa përpiqem të të shoh në sy për të bashkëbiseduar me plot sinqeritet, ndërkohë që ti humbet vështrimet e tua përtej, thuajse vështrimi im të rëndon.

Ti vërtet more një diplomë për një X profesion, po diplomën e jetës kur mendon ta marrësh, që të më kuptosh mua si nxënësin tënd, si fëmijën tënd, si punonjës tënd?!

Unë jam qenia njerëzore që më solle në jetë, jo për t'u bërë robot i sjelljeve pa sens, por për të triumfuar me një mendje dhe shpirt unik, pasi i tillë erdha në këtë jetë dhe si i tillë edhe do largohem. Ndaj kthjellohu që të më kuptosh!...

BUSRA, QYTETI NË SIRI KU PROFETI MUHAMED TAKOI PRIFTIN BAHIRA

Gjatë gjithë historisë, Busra ka qenë në kryqëzimin e rrugëve tregtare që shtriheshin nga Meka në Damask dhe prej andej në portet mesdhetare.

I vendosur në jug të Sirisë, në kryqëzimin e rrugëve tregtare që shtrihen nga Meka në Damask gjatë gjithë historisë, qyteti i lashtë Busra (Bosra) njihet për strukturën e pasur historike, duke qenë se ka pritur qytetërime të shumta, ndërkohë ai ka një vend të veçantë në historinë islame si vendi ku Profeti Muhamed (a.s.) u takua me priftin Bahira.

I vendosur 40 kilometra nga qendra e qytetit Dara, pranë kufirit jordanëz dhe 140 kilometra nga Damasku, Busra shquhet për historinë e saj me shumë faza që shtrihet nga Perandoria Romake në Perandorinë Osmane.

Gazetari i AA-së përpiloi sfondin historik dhe rëndësinë e qytetit nga dokumente të Ministrisë siriane të Turizmit dhe informacione nga burime të hapura.

Emri i qytetit është shfaqur për herë të parë në listat e qyteteve të Faraonit egjiptian Thutmose III në shekullin e 15-të para Krishtit. Është regjistruar si “Buzruna” në pllakat Al-Amarna të shekullit të 14-të para Krishtit.

Busra, një nga qytetet e rëndësishme të Mbretërisë Nabateane në periudhën para-romake, u bë kryeqyteti i provincës Arabistan gjatë periudhës romake.

Gjatë periudhës bizantine, Busra u ngrit për t'u bërë një treg i madh dhe qendër fetare. Busra, një nga qytetet e para bizantine të pushtuara nga ushtritë islame në vitin 634, u bë qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore gjatë periudhës Umajade.

Qyteti, i cili ka qenë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s që nga viti 1980, është i njohur për teatrin e tij madhështor romak dhe objektet nga periudhat e hershme të Islamit.

Pikë ndalesë për karvanet që udhëtonin nga Meka në Damask

Gjatë gjithë historisë, Busra ka qenë në kryqëzimin e rrugëve tregtare që shtriheshin nga Meka në Damask dhe prej andej në portet mesdhetare.

Një ndalesë e shpeshtë për karvanet e deveve, qyteti shërbeu si një qendër



e tregtisë rajonale nga romakët deri te osmanët.

Qyteti shërbeu si një depo tregtare, duke mbledhur prodhime nga rajonet e gjera bujqësore përreth dhe duke i transportuar ato në qendra më të mëdha.

I njohur si vendi ku Profeti Muhamed takoi priftin Bahira

Busra mban një vend të veçantë në historinë islame. Sipas burimeve të historisë së jetës së Profetit, para se Muhamedi të bëhej profet, ai udhëtoi dy herë në Busra. Gjatë udhëtimit të tij të parë kur ishte 9 ose 12 vjeç dhe i shoqëruar nga xhaxhai i tij Ebu Talibi, një klerik që jetonte në një manastir në Busra, një prift me emrin Bahira e pa Muhamedin dhe i tha se ai do të bëhej profet.

Udhëtimi i tij i dytë ndodhi në moshën 25 vjeç, ndërsa udhëhiqte karvanin e Hatixhes. Gjatë këtij udhëtimi, murgu Nastura, duke vënë re vendin ku ai ndaloj, tha për Muhamedin: “Askush përveç profetit nuk ka zbritur kurrë nën këtë pemë.”

Ekipi i AA-së filmoi gjendjen aktuale të manastirit, të emëruar sipas priftit Bahira.

Vetëm disa rrënoja kanë mbijetuar nga manastiri, i cili besohet të jetë ndërtuar rreth 1.500 vjet më parë. Pjesët e mureve prej guri, themelet e kolonave dhe pjesa e gjysmë-rrethore (absida) e strukturës, që mendohet se daton që nga periudha e hershme e krishterë, janë ende në këmbë.

Ahmed El-Mikdad, një nga banorët e zonës që kryen guida turistike në qytet, tha: “Ky është qyteti i lashtë.

Njihet si zona ku Profeti Muhamed

takoi priftin Bahira kur ishte fëmijë. Bahira u njoh me Profetin këtu. Para luftës, afro 40 mijë njerëz jetonin në qytetin e Busrës (qyteti i lashtë dhe rrethinat e tij), ndërsa vetëm 5.000 njerëz jetonin në qendër të qytetit të lashtë.”

“Njerëzit jetonin këtu dhe ishte destinacion i madh turistik. Si rezultat i sulmeve nga regjimi i Asadit dhe milicisë e mbështetura nga Irani, 99 për qind e popullsisë vendase u zhvendos. Manastiri u dëmtua nga sulmet”, tha ai.

Gjithashtu Mikdad tërhoqi vëmendjen mbi rëndësinë e rajonit duke ndarë detaje që dinte për takimin midis priftit Bahira dhe Profetit Muhamed. Ai theksoi se dëmet e shkaktuara nga regjimi i rrëzuar Baath nuk ishin riparuar dhe i bëri thirrje qeverisë së siriane të restaurojë zonën dhe ta hapë atë për turizëm.

Xhamia Mabrak El-Naka në gjendje të rrënuar

E vendosur në pjesën verilindore të qytetit të lashtë, xhamia Mabrak El-Naka (xhamia e vendit ku u gjunjëzua deveja) njihet për memorien e saj të shenjtë dhe ka rëndësi shpirtërore për myslimanët në mbarë botën.

Në “Librin e Udhëtimit”, udhëtari i njohur mysliman Ibn Battuta thotë se deveja që mbante kopjen e parë të Kuranit të dërguar në Siri (Damask) u gjunjëzua këtu dhe se kopja u ruajt atje. Ibn Battuta vë në dukje se pasi largoheshin nga Damasku, haxhinjtë shkonin në qytetin e vogël Busra dhe se e kishin bërë zakon të qëndronin aty 4 ditë, në mënyrë që ata që mbeteshin të arrinin karvanin.

Xhamia, e ndërtuar në vendin ku

u gjunjëzua deveja në Busra, është bërë vend i rëndësishëm adhurimi dhe vizitash për banorët vendas. Struktura, e cila qëndron në këmbë sot, mbetet një nga strukturat e njohura të Busrës, një Vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, si me rëndësinë e saj fetare ashtu edhe me vlerën arkeologjike.

Muezini i xhamisë, Abdullah Nicim, tha se xhamia u ndërtua në vendin ku deveja e Profetit Muhamed u gjunjëzua, duke thënë: “Deveja që mbante Kuranin u gjunjëzua këtu. Deveja (e cila u soll brenda për mbrojtje) u gjunjëzua mbi këtë shkëmb dhe pastaj vazhdoi për në Damask.”

Ai tha se struktura historike ka nevojë për mirëmbajtje. “Xhamia aktualisht ka nevojë për ndriçim. Nëse ka të paktën një panel diellor, ata që vijjnë në xhami mund ta lexojnë Kuranin brenda”, shtoi Nicim.

Myslimanët vazhduan të udhëtonin në Busra për tregti pas hixhretit. Në të vërtetë, hazreti Ebu Bekri udhëtoi në Busra për tregti me dy shokë që morën pjesë në Betejën e Bedrit para vdekjes së Profetit Muhamed.

Sipas burimeve nga jeta e Profetit në Enciklopedinë Islame të Fondacionit Fetar Turk (TDV), Busra u pushtua në mënyrë paqësore në fillim të vitit 634 pas një rrethimi të shkurtër nga Khalid ibnul-Velid me urdhër të Kalifit Ebu Bekr. Me Damaskun që u bë kryeqytet gjatë periudhës Umajade, rëndësia e Busrës filloi të binte dhe kjo situatë vazhdoi gjatë periudhës Abaside.

Kur Busra ra nën sundimin osman, Sulltan Selimi I ndërtoi një fortesë në Muzajrib dhe e zhvendosi qendrën administrative të rajonit atje.

Gjatë periudhës osmane, Busra u bë një fshat me disa qindra familje, i njohur si Damasku i Vjetër, brenda distriktit Havran të provincës së Damaskut dhe i paguante një shumë të caktuar taksash guvernatorit. Evlija Çelebi në shkrimet e tij e përshkruan Busrën si një fshat të begatë me 300 familje dhe një xhami.

Disa fise turkmene që jetonin në Anadoll vinin në Busra për të kaluar dimrin dhe ktheheshin në shtëpitë e tyre në pranverë. Një familje e madhe me prejardhje nga sahabët (shokët e profetit), Mikdad ibn Esved, dhe që emërtohej Mikdadija, jetonte në Busra. Për shkak të prestigjit të tyre në Perandorinë Osmane dhe veçanërisht në sytë e Abdulhamidit II, Hekurudha e Hixhazit u zgjerua me një linjë degëzimi

midis Muzajribit dhe Busrës gjatë ndërtimit të hekurudhës.

Ofron udhëtim në kohë

Gjatë gjithë historisë, Busra është ndikuar nga qytetërimet akadiane, amoreje, kananease dhe arameane, si dhe nga qytetërimet romake dhe bizantine, dhe strukturat e saj historike u ofrojnë vizitorëve një udhëtim në kohë.

Rajoni krenohet me struktura të shquara historike si Teatri Romak (teatri i lashtë), Kështjella e Busrës, Tempulli i Serir Bint El-Malik, Harku i Triumfit dhe portat El-Hava dhe El-Nabati.

Teatri Romak, një nga strukturat ikonike të Busrës, u ndërtua në shekullin e 2-të gjatë mbretërimit të perandorit Trajan. Me një kapacitet prej 15 mijë personash dhe punime me gurë bazalti, ai mbetet struktura më madhështore në rajon.

Nga shekulli i 7-të e tutje, rreth teatrit u shtuan fortifikime të trasha, kulla dhe bastione, duke e transformuar atë në një fortesë. Struktura u përdor për qëllime mbrojtëse gjatë kryqëzatave. I konsideruar si një nga të paktat teatro të lashta romake plotësisht të paprekura në botë, muret dhe kullat përreth janë ende të dukshme.

Gjatë luftës civile siriane, shumë struktura historike në qytetin e lashtë u dëmtuan nga sulmet e forcave të regjimit të rrëzuar. Nëse turizmi ringjallet, Busra mund të bëhet përsëri një destinacion turistik.

U bë fortesë e demonstratave kundër regjimit të Asadit, u dëmtua nga sulmet

Busra ishte një ndalesë kyçe për demonstratat paqësore popullore kundër regjimit që filluan në jug të vendit në mars të vitit 2011 në Siri. Mijëra njerëz morën pjesë në demonstrata çdo të premte pas lutjeve gjatë gjithë luftës civile, duke u përpjekur të bënin që zëri i tyre të dëgjohet.

Ndërsa forcat e regjimit filluan të humbnin kontrollin e jugut, ato filluan të shënjestronin rajonin nga ajri dhe toka. Forcat e regjimit të rrëzuar të Asadit e përdorën Teatrin e Busrës si një pikë ushtarake në sulmet e tyre ndaj popullsisë lokale.

Ekipi i AA-së ka regjistruar me dron gjendjen më të fundit të strukturave historike dhe të shtëpive të evakuuara, të cilat janë përballur me sulmet në rajon.

(www.trtbalkan.com)



SHEJKH MUHAMED EL-GAZALI
(1917 - 1996)

“

Njeriu shndërrohet në egërsirë vrastare kur harron Allahun dhe ditën e gjykimit, sidomos kur ky njeri është ligjvënës dhe ligjzbatues!

Atëbotë liqji ruan të fortët dhe përdhosë të dobët.

Këtë e kemi parë, se si shfaroset populli i Palestinës dhe zhduket ekzistenca e tij në tokën e vet, e sillen mijëra të tjerë jehudi, për të jetuar mbi rrënojat e tyre!

Ndërkohë liqji ndërkombëtar është gojëmbyllur, sepse poseduesit e fuqisë e duan këtë gjë dhe mjetet e propaqandës janë të afta ta zhbëjnë të vërtetën dhe ta vërtetojnë të kotën!!



NË PRAG TË INAUGURIMIT QENDRA E RE KULTURORE PRANË XHAMISË BARDHAJ

Paraditen e së enjtes, më 2 tetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari së bashku me drejtorin e Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, zhvilluan inspektimin e fundit në prag të përfundimit të Qendrës Kulturore pranë xhamisë së fshatit Bardhaj.

Në shoqërinë e imanit të xhamisë, H. Ilir Dizdari, menaxherëve Blendi Alushi dhe Syrgen Cani, zhvillua inspektimi i krejt objektit, ku u vu në dukje domosdoshmëria e kësaj Qendre për xhaminë e fshatit Bardhaj dhe shërbimet që do të ofrojnë në të ardhmen për besimtarët dhe frekuentuesit e saj.

Myftiu falënderoi kontributin e madh të Fondacionit “Mirësia” dhe i



shprehu z. Korab Kaja mirënjohjen e tij të thellë dhe të Myftinisë Shkodër për bashkëpunimet e frytshme në dy dekadat e fundit.

Dita e përfundimit të Qendrës së re



Kulturore pranë xhamisë së fshatit Bardhaj do të shoqërohet edhe me një program artistik nga fëmijët e kësaj xhamie, si një ditë festive e shumëpritur për besimtarët e këtij fshati.

DY ILAHISTË ME FAMË BOTËRORE VIZITOJNË XHAMINË E PLUMBIT

Ditën e mërkurë, më 8 tetor 2025, atmosfera e begatë e 35-vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, një prej monumenteve më të rëndësishme të trashëgimisë islame dhe kulturore të Shkodrës dhe mbarë trojeve shqiptare; u zbkurua me vizitën e dy miqve të veçantë për Myftininë e Shkodrës.

Në një veprimtari krejtësisht të veçantë nga krejt të tjerat, në xhaminë e Plumbit ditën e sotme ishin të pranishëm dy ilahistët me famë botërore, prof. Muhamed Tarik nga Egjipti dhe Hfz. Egzon Ibrahim nga Kosova, të cilët e vizituan xhaminë e Plumbit me qëllim realizimin e një ilahije të re, në gjuhën arabe dhe shqipe.

Në pritje të dy miqve të shtrenjtë ishte Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi dhe përgjegjësi i sektorit të arsimit dhe medias pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni.

Në fjalën e tij përshëndetëse, përpara mediave të pranishme, Myftiu i Shkodrës shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë të shtrenjtë të dy ilahistëve me famë botërore dhe ndër të tjera, theksoi se: “Kjo vizitë është pjesë e atmosferë së begatë të 35-vjetorit të rikthimit të lirisë së besimit në Shqipëri — një ngjarje historike që shënoi fillimin e një epoke të re për aktivitetin fetar dhe trashëgiminë



shekullore islame të popullit tonë.”

Nga ana e tyre miqtë e dashur, shprehën emocionet dhe gëzimin e tyre për praninë në Shkodër, për realizimin e një ilahije të re kushtuar Kur'anit Famëlartë, e cila shoqërohet edhe nga prania e disa nxënësve të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”.

Në fjalën e tij përpara mediave, Hfz. Egzon Ibrahim ndër të tjera tha: “Ndjej emocione të veçanta për vizitën në xhaminë e Plumbit, si një vend i shtrenjtë që simbolizon qëndrueshmërinë e besimit dhe trashëgiminë shpirtërore të Shkodrës. Dëshirojmë që nëpërmjet kësaj ilahije kjo xhami të shikohet në mbarë botën islame, përmes realizimit të prodhimit tonë më të ri.”

Ndërsa, ilahisti i shquar egjiptian me banim në ShBA, prof. Muhamed Tarik shprehu emocionet e tij për këtë vizitë

të parë në vendin tonë dhe në Shkodër veçanërisht, ku theksoi se: “Jam shumë i lumtur për vizitën time në Shqipëri dhe dua të falënderoj Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed Sytari për mikpritjen dhe gatishmërinë e tij në realizimin e këtij projekti të ilahisë.”

Për disa orë me radhë ilahistët e nderuar kryen incizimet e projektit të tyre më të ri, i cili pritet të dalë gjatë këtyre ditëve, si një dhuratë e çmuar që lidh edhe qytetin e Shkodrës, xhaminë e Plumbit dhe Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” me mbarë botën islame nëpërmjet dritareve të këtyre dy personaliteteve të shquara të artit islam.

Për nder të miqve Myftiu shtroi edhe darkën e mikpritjes, ku u diskutuan biseda të shumta me interes të përbashkët.

PËRURORHET QENDRA KULTURORE BARDHAJ



Ditën e shtunë, më 11 tetor 2025, në kuadër të 35 vjetorit të rihapjes së kulteve të besimit islam, Myftinia Shkodër organizoi përmes një ceremonie përfundimit të Qendrës së re Kulturore Bardhaj, financuar nga bamirës të Shtetit të Kuvajtit dhe ndërtuar nga Fondacioni “Mirësia”.

Me pjesëmarrjen e besimtarëve të zonës dhe të shumë nxënësve të kësaj Qendre dhe të qendrave të tjera kulturore, pas hapjes nga përgjegjësi i arsimit, teologu Arben Halluni, fjalën e rastit të përfundimit e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili fillimisht falënderoi vëllezërit nga Kuvajti dhe fondacionin “Mirësia”, ndërsa theksoi se tashmë fëmijët tanë kanë një mjedis dhe një klasë më shumë për edukim dhe argëtim, gjë që do t'i gëzojë e lumturojë edhe prindërit e tyre, sepse fëmijët ndodhen në duar të sigurta, të cilat garantojnë rritjen e tyre me frymën e drejtë dhe të vërtetë fetare.

Ndërkohë, Myftiu tha se projekte të tilla do të shërbejnë në gjallërimin e jetës

fetare, sociale dhe edukimit të fëmijëve më mësimet fetare dhe jo vetëm.

Në përfundim, Myftiu i bëri një dhuratë simbolike që lidhet në nderim të personalitetit të tij për të cilin theksoi: “Kontributi i madh i z. Korab Kaja, gjatë 15-ve të fundit në Shkodër, në fusha të ndryshme të bamirësisë e bën atë një Qytetar Nderi të Shkodrës, sepse në të vërtetë askush nuk ka kontribuuar në fusha të ndryshme të bamirësisë për këtë qytet në këtë periudhë kohore më shumë se sa Fondacioni “Mirësia”, të cili i jemi mirënjohës pafund!”

Ndërsa, drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, në përshëndetjen e tij, falënderoi Myftininë Shkodër për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre, duke shprehur kënaqësinë për këtë qendër kulturore dhe edukuese që iu ofrohet fëmijëve dhe të rinjve të zonës.

Në një atmosferë festive ceremonia u shoqërua me një program artistik nga nxënësit e mejtepit të xhamisë Bardhaj.

Ceremonia e përfundimit përfundoi



MYFTINIA E SHKODRËS DISKUTON FAZËN E DYTË TË PROJEKTIT TË ZDRALES



Paraditen e të enjtes, më 23 tetor 2025 u zhvillua një mbledhje pune e stafit të Myftinisë Shkodër, e cila u drejtua nga teologu Arben Halluni.

Gjatë mbledhjes u diskutua për fillimin e punimeve të fazës së rehabilitimit të ambienteve të jashtme të xhamisë, që zhvillohen në kuadër të projektit të Bashkisë Shkodër për rehabilitimin e zonës së Zdrales.

Po ashtu, stafi i Myftinisë Shkodër trajtoi disa çështje paraprake që lidhen me ecurinë e fillimit të punimeve dhe organizimin e tyre, si dhe me mënyrën e njoftimit të xhematit lidhur me zhvillimet dhe masat që do të ndërmerren gjatë kësaj periudhe.

me fjalën e imanit dhe mësuesit të përkushtuar të xhamisë dhe Qendrës Kulturore Bardhaj, H. Ilir Dizdari si dhe më pas me prerjen e shiritit dhe zbulimit të pllakës, vizitën e ambienteve të qendrës dhe shijimin e një koktejl, të përgatitur enkas për këtë ceremoni përfunduese.

MYFTINIA SHKODËR DHE KISHA ORTODOKSE KRAH PËR KRAH NË MBROJTJE TË SË DREJTËS SË PRONËS

Ditën e hënë, më 13 tetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim në Kishën Ortodokse Shkodër, ku u prit nga At Aleksandër Petani dhe At Nikolla Petani dhe bashkërisht, ku diskutuan rreth çështjeve me interes të përbashkët, duke u përqendruar tek problematika e zaptimit ilegal të pronës së dy komuniteteve në zemër të Shkodrës.

Gjatë një konference për shtyp, Myftiu Sytari dhe At Aleksandër Petani theksuan domosdoshmërinë e respektimit të pronës legjitime dhe kthimit të saj tek i zoti, ku ndër të tjera At Aleksandër Petani theksoi se: “Në ligjet në atyre ku duam të hyjmë ne, në Bashkimin Evropian tre ligjet e para janë të: Liria, feja dhe prona. Këto dy të fundit po shkelen me këmbë dhe po grabiten..!”

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ritheksoi se, përpjekjet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Myftinisë Shkodër së bashku me Kishën Ortodokse dhe familjen Laçeji në drejtim të kthimit të pronës legjitime tek xhamia e Fushë Çelës dhe Hotel Turizmi janë të kahershme, gjyqe të shumta janë



zhvilluar, shkresa të shumta janë dërguar, takime të shpeshta janë zhvilluar dhe për fat të keq sot ndodhemi në këtë realitet që e dëshmojmë të gjithë.

Myftiu theksoi, se: “Meqenëse ne jemi në 35 vjetorin e rihapjes së kishave dhe xhamive, është shembulli më i keq se si shteti në vend që të respektojë komunitetet fetare dhe të mbyllë një herë e përgjithmonë problemin e madh të pronave, lejon që të rigrabitet prona e komuniteteve fetare..!”

Pyetjes së gazetarit, se a do të ketë protesta nga komuniteti musliman në lidhje me këtë çështje, myftiu iu përgjigj,

se: “E pyetën muajin Ramazan se, pse nuk vjen në muajin Shaban, tha: Çdo gjë në kohën e vet është e bukur dhe e duhur!”

Njëkohësisht, Myftiu tha se: “Komuniteti musliman është komuniteti më i madh fetar në vend, dhe vetëm shpërndarja gjeografike e xhamive tona dhe e komunitetit tonë, na fton që edhe kur të flasim të jemi shumë të përgjegjshëm për atë që themi, por edhe ata që mendojnë të shkelin të drejtat edhe hakun tonë, duhet të mendohen shumë e shumë, përpara se ta bëjnë një gjë të tillë!”

U MBYLL ME SUKSES CIKLI 2 I HYTBEVE TË MEVLUDIT 1447 NË XHAMINË E PLUMBIT

Në kuadër të 35-vjetorit të hapjes së xhamisë së Plumbit dhe përkujtimit të Mevludit Sherifë, muajit të Lindjes së Begatë të Pejgamberit (a.s), Myftinia e Shkodrës zhvilloi Ciklin 2 të hytbeve të Mevludit 1447, të mbajtura në xhaminë e Plumbit në periudhën 5 shtator deri më 31 tetor 2025.

Përmes këtij cikli hytbesh të veçanta, synohej përcjellja e mësimave dhe këshillave me vlerë nga jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s), të cilat mbartin mesazhe universale të mëshirës, tolerancës, bashkëjetesës dhe vëllazërisë njerëzore të mbarë popujt e botës, duke ditur se Pejgamberi (a.s) u dërgua mëshirë dhe i dërguar për mbarë njerëzimin.

Në këtë cikël hytbesh morën pjesë imamët hatibë dhe teologë të Myftinisë Shkodër sipas një kalendari dhe programit të publikuar më parë, duke filluar me hytben e parë më 5 shtator 2025, të mbajtur nga H. Alban Kali dhe duke vijuar më pas me hytbet e tjera nga H. Besim Barbullushi, H. Ardit Hoxha, H. Ervin Juku, H. Ervis Molla, H. Sadri Ujkaj, H. Anis Agovi, H. Arben Halluni dhe H. Ademir Xama, i cili mbajti hytben e fundit të këtij cikli, më 31 tetor 2025.

Ky program i larmishëm hytbesh, temash dhe hatibësh u prit mirë dhe u vlerësua nga besimtarët dhe veçanërisht nga xhamati i xhamisë së Plumbit, e cila pas rikonstruksionit të kryer, është kthyer në një tërheqje të shtuar të vizitorëve të shumtë vendas dhe të huaj, që e frekuentojnë këtë xhami duke marrë mirësitë dhe bekimet e shtëpisë së Zotit.

Përmes këtyre hytbeve, Myftinia e Shkodrës synon të përcjellë mesazhet

islame të mëshirës, solidariteti, tolerancës dhe vlerave njerëzore, që mbart dhe promovon Islami për të gjithë njerëzit.

Myftinia Shkodër, duke shprehur në zhvillimin e cikleve të tjera, falënderon të gjithë imamët dhe hatibët, të cilët morën pjesë në këtë cikël hytbesh, ku me kompetencë dhe përgatitje shkencore arritën të përcjellin mesazhet e duhura dhe më të mira.



MEJTEPI IM... XHAMIA BËRDICË E MESME

PAK HISTORI:

- Xhamia Bërdicë e Mesme ndodhet në Njësinë Administrative “Bërdicë”, Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 230 familje myslimane. Familjet më të njohura në Bërdicë të Mesme janë: Velidani, Beqiraj, Hoxhaj, Selimaj, Cufsalaj, Halilaj, etj.

- Xhamia e re pas rikthimit të lirisë së besimit në vendin tonë është ndërtuar në vitin 1993 me kontributin financiar të besimtarëve të dy fshatrave, Bërdicë e Mesme dhe Bërdicë e Madhe, në themelet e xhamisë së parë.



Ndërsa xhamia tjetër e re që është funksionale është ndërtuar në vitin 2016.

- Në këtë fshat nga viti 2002 deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve; H. Skënder Dani, H. Ermi Duka, H. Sajmir Sela dhe imami e mësuesit aktual, H. Ilir Hoxha dhe znj. Kimete Elezi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 18 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2025 është mbi 380 nxënës dhe nxënese.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vazhden e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë

kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, ditën e hënë, më 20 tetor 2025 zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e mejtepit të ri/kursit fetar në Bërdicë të Mesme.

Fillimisht, teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin duke përcuar te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, zbatimin e programit mësimor të Myftinisë Shkodër, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesja znj. Elezi, nën kujdesin e imamit H. Hoxha.

Në fund të takimit u zhvilluan pyetje dhe përgjigje rreth mësimave që marrin fëmijët gjatë këtij procesi mësimor në xhaminë Bërdicë e Mesme.





MYFTINIA SHKODËR

PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

**“KUSH GRABIT PADREJTËSISHT,
QOFTË EDHE NJË PËLLËMBË TOKË,
në Ditën e Kiametit
Allahu ka për t’i varur në qafë
shtatë palë tokë!”**

(Transmeton Muslimi)

www.myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org